



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Mbledhja është mbajtur më 07.05.2020 (e Enjte), në Shkollën e Mesme Teknike “Januz Zejnullahu” në Viti, duke filluar me punë në ora 11 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Naim Pira, nënkryetari i Komunës, z.Hasan Aliu, këshilltarët e Kuvendit (Basri Sylejmani, Zejnepe Osmani, Valbona Haziri, Ramadan Deliu, Ali Bajrami, Xhilsime Qamili, Nuredin Lutfiu, Taibe Ibrahim, Zekirja Zuka, Nijazi Isaku, Jakup Demiri, Sejdi Emini, Remzi Salihu, Mirlinda Sadiku, Liridona Bislimi, Bekim Azizi, Taulant Haxhiu, Blerina Lubishtani, Samet Idriizi, Idajete Pira, Avdi Rexhepi, Vehbi Rama, Ekrem Abazi, Valentina Hasani, Rasim Terziqi, Besim Ymeri). Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive dhe mjetet elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 27 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e dytë të jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Vitisë. Më lejoni ta përshëndes nënkryetarin, drejtorët e drejtorive, ju asamblist dhe mjetet e informimit. Kemi thirr këtë seancë të jashtëzakonshme për faktin se akoma nuk na ka lejuar ministria të mbajmë KPF-në. Një falënderim për gjithë ata që ishin në këtë grup emergjent për plot 2 muaj që është duke zgjatur kjo pandemi. Për ma shumë ja kisha kaluar fjalën nënkryetarit, për arsye se e din, se në seanca të jashtëzakonshme nuk ka debat.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Më lejoni të ju përshëndes të gjithë këshilltarëve të kuvendit komunal, medie të shkruara dhe elektronike, personel mjekësorë të cilët po kryen procedurat e vet, a dëshira jonë ka qenë që kjo seancë t’i kthehet normalitetit, ti kthehemi jetës normale, por megjithatë gjendja që është në Kosovë për shkak të pandemisë nuk lejon një gjë të tillë. Vitia ishte vatrë e parë me 53 të infektuar dhe fatmirësisht kemi 42 të shëruar, kemi edhe 11 që janë ende aktiv me CV 19, po besojmë dhe shpresojmë se nesër do të merren rritestimet dhe shpresojmë se ky numër do të zbritet edhe ma tutje. Kam dy kërkesa për këshilltarët, para se me hy në rend të ditës, kërkesa e cila është shumë e nevojshme dhe e domosdoshme, që unë besoj se duhet me pas mirëkuptimin e juaj. Kam qenë në negociata para se me hy në këtë gjendje me një propozim vendim 11.03.2019, që ka qenë drejtoresha e QKMF-së, se bashku me drejtorin e Shëndetësisë me shtetin e Kuvajtit për ndërtimin e ambulantes në Tërpezë dhe na u ka kërkuar që ne ta ndajmë lokacionin. Prandaj kisha kërkuar me mirëkuptimin e juaj edhe të kryesuesit që këtë pikë sot ta shtim në rend të ditës edhe ta kalojmë, për shkak se ata na i kanë kërkuar dhe 2. Tu e pas parasysh që në seancën kaluar me propozim nga ana e ekzekutivit dhe me miratim në plotëni nga ana e juaj, e ndatë shumë e 100 mijë eurove për nevojat e pandemisë dhe ne si ekzekutiv kemi udhëhequr procedurat, është shpall fituesi, pritët ardhja e të mirave materiale me pako ushqimore dhe me koordinim të plotë me ekzekutivin e kemi parë të udhës që sipas dëshirës së juaj që ta formoni një komision prej 3 anëtarëve dhe ta përcjellin shpërndarjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Dua të sqaroj, se në seanca të jashtëzakonshme duhet të vij një pikë e rendit të ditës, por unë jam konsultuar me ministrinë. Kur ka të bëjë me buxhetin mundemi edhe ma shumë pika për propozimin e juaj nënkryetar, do t'i qesim në votim me rend dite, megjithatë unë po jav kaloj me rend fjalën, nëse kanë ndonjë pyetje rreth pandemisë.

z.Ali Bajrami: Përshëndetje për nënkryetarin, kolegë asamblist, zonja dhe zotërinj. Ne si grup parlamentar i LDK-së, do të jemi shumë falënderues për të gjithë ata për punën, angazhimin dhe kontributin që e kanë dhënë rreth menaxhimit në mënyrën sa ma të mire të mundshme me CV 19. Nuk kisha hy me I cek me emra. Falënderimi shkon prej shtabit emergjent dhe dashtë Zoti që këtë pandemi ta përfundojmë si komunë pa asnjë viktimë. Po e shfrytëzoj rastin si shef i grupit parlamentar për komisionin për mbikëqyrjen për ndarjen e ndihmave. Ne e propozojmë z.Zekirja Zuken.

Znj.Mirlinda Sadiku: Kam një pyetje shumë të rëndësishme në një kohë pandemie, shpeshherë në Plus Televizion z.Basri Aliu thirret si drejtor I DKA-së, nganjëherë prononcohet si drejtor I Shëndetësisë, në këtë kohë pandemie a keni drejtor të shëndetësisë edhe se ai ka mbet I zbrazet qe 2 muaj edhe është me rëndësi të thuhet, se Ministria e Shëndetësisë qysh para fillimit të pandemisë me 11 mars ka dërguar donacionin e parë edhe 13 mars, 24 mars, 28 mars, d.m.th nuk është që edhe ministria e shëndetësisë nuk I ka kthyer sytë edhe nga komuna, ka pas shumë prononcime publike për të cilat e kanë atakuar si ministri dhe për të ja shtuar edhe këtë edhe shumë organizata të mëdha ndërkombëtare e kanë vlerësuar, se Kosova e ka menaxhuar situatën me CV 19 në mënyrën ma të mire të mundshme, duke pasur parasysh kapacitetet e saja edhe humane po edhe shëndetësore. Për komision propozoj znj.Liridona Bislimin.

z.Bekim Azizi: Përshëndetje për të gjithë! E dimë që jemi me një kohë të pandemisë. Dhashtë Zoti të jetë fundi i saj që edhe po shihet se është një lehtësim tash edhe I masave edhe një rënie e numrit të infektuarëve, besoj se edhe në fund duhet të jemi të gjithë të angazhuar që të marrim masa që po kërkohen nga ekspertet e lëmive përkatëse që ta kalojmë këtë kohë, ndërsa për menaxhimin na nuk jemi për me dhanë ndonjë mendim, mirëpo e dimë që ka pasur angazhim nga çdo institucion, nga çdo individ, nga komuna nga partitë politike, nga qytetaret në veçanti nga mjeket që ë përshëndes shumë edhe dy këshilltarët mjekë që I kemi në Kuvend. Prej grupit tonë propozoj Taulant Haxhiun për komision.

z.Vebi Rama: Sa I përket pandemisë, është për me ju falënderuar të gjithëve, edhe ekipit mjekësorë edhe policor. Një falënderim të veçantë kisha me dhanë edhe për media në përgjithësi në Viti, në veçanti televizionin plus. Sa I përket shtabit, ka qenë në nivel edhe se kjo ndihmë që është shpërnda nga kuvendi komunal në vlerë prej 100 mijë eurove, ndoshta pak është vonuar. Para do dite u takova me pronarin e mullirit "THES ARI", tha, është një donacion të cilën donatoret e kanë paguar, por fatkeqësisht nuk kanë ardhur me marr, ndoshta edhe nuk ka nevojë. Sa I përket anëtarit të komisionit do të shkoj unë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Unë desha t'i falënderoj shefat e grupeve parlamentare, që sa herë kemi pas nevojë na, u janë përgjigjur pozitivisht. Nëse donë nënkryetari me u përgjigj në pyetjet, urdhëro fjala është për ty.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Motoja e këtij këshilli ka qenë, "pa bukë kërkush", por edhe tepricë askush. Këshilltare, nuk dua me e vlerësuar veç kuvendi komunal organet komunale për çka je kompetent, atë dikush tjetër ka me vlerësuar, kur I vjen koha. Çështja e drejtorit është, se e ka nxan koha e pandemisë, veç po ju njoftoj se 10 drejtorit secili e zëvendëson njëri tjetrin me rastin e pushimit. Ka koicidua gjithherë drejtori I Shëndetësisë me zëvendësuar atë të arsimit

z.Taulant Haxhiu: Unë së pari desha t'i falënderoj të gjithë ata që dhanë maksimumin që ta kalojmë këtë situatë, e cila e ka kapluar botën. Falënderoj Policinë e Kosovës, mjeket, zjarrfikësit, Forcat e Sigurisë së Kosovës. Unë sot nuk desha të bëjë politikë ose të flas diçka për poena politik, për shkak të gjendjes e cila është në vendin tonë, veç desha të di nga nënkryetari ose drejtori përfituesi i pakës për ndihmat që shpërndahet për familjet me nevojë. Me sa morra informatën, është nga Prishtina. Unë vij nga biznesi dhe në Komunën e Vitisë ka shumë biznese që kanë

potencial edhe kanë kapacitet për t'i mbuluar këto pako. Te këta artikuj është mirë të verifikohet çmimi përçdo artikull, pasi që janë artikuj esencial dhe të domosdoshëm. Ne do t'i verifikojmë të gjitha çmimet se sa të ketë çmime ma të lira aq ma shumë pko do të fitojnë qytetarët e komunës sonë. Kështu që, është një gabim që përfituesi të jetë nga Prishtina dhe pse mos ta ketë një përfitues nga Komuna e Vitisë.

z.Jakup Demiri: Unë desha me bë një pyetje për drejtorin e Shëndetësisë apo të Arsimit, pasi që është liruar situata me virus: a ka ndonjë afat apo kohë kur lirohen çerdhet e fëmijëve, kam kërkesë nga një qytetar.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Taulant, pyetjen e pare të cilën ja kam bërë pas shpalljes së tenderit ka qenë sa kompani të Komunës së Vitisë kanë konkurruar. Plotësisht kam qenë në anën tënde, po ata të ishin qenë konkurrent dhe ata të cilët kanë punuar në momentin e shpalljes së përfituesit, fitues janë vetëm ata që kanë hyrë në konkurrim, prandaj e ka fituar një e Prishtinës, që nuk e di as unë kush është, ndërsa sa I përket pyetjes tjetër se kur do të lirohen çerdhet, unë konsideroj se gjithçka varet nga udhëzimet që na vinë nga ministria.

z.Taulant Haxhiu: Unë kam biseduar me biznese ata nuk kanë qenë të informuar as kur shpallet tenderi, por beso pasi që jam pjesë e komisionit, e di që nuk je as ti me i keqpërdor, e di se gjatë kohës së pandemisë ke qenë çdo ditë ne vend të punës. Të falënderoj për këtë, por çdo artikull që ka në atë pako, kemi me i shikuar çmimet se ai e ka marr si ofertuesi ma i lirë, sado të kemi çmime më të lira, aq ma shumë pako do të përfitojnë qytetarët e komunës sonë, por edhe një herë po të them beso se bizneset të komunës sonë nuk kanë qenë të informuar për tenderin.

z.Samet Idriz: Shfrytëzoj rastin me i falënderuar mjeket, policët dhe gjithë. Për sqarim, nëse është vepruar me procedurë të hapur, atëherë kanë mund me konkurruar të gjithë nëse është përdorur procedura e negocimit. Pa publikim të kontratës nuk ka mundësi me ditë askush prej operatorëve ekonomik, përveç atyre që ti dëshiron me i njoftuar.

z.Ibrahim Ramiqi: Një sqarim të shkurtër, nuk jam pjesë e Zyrës së Prokurimit, por po e bëj me dije procedurën. Ligjërish janë udhëheq me formën e negocimit. Kjo është e përcaktuar me udhëzimin administrativ në kohë pandemie. Ministria e financave i ka udhëzuar të gjitha komunat, kjo ka qenë edhe nëpër mjete të informimit për hirë të situatës.

Kryesuesi z.Naim Pira: Po mbetet që Zyra e Prokurimit të na i sjell një informatë në seancën e radhës. Po besoju dhe shpresoj që në seancën e ardhshme do ta kemi edhe si pikë të veçantë të rendit të ditës. Rreth kësaj çështje, për këtë seancë të jashtëzakonshme, kemi paraparë këtë:

R e n d d i t e

- 1. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2019 në vitin 2020.**
- 2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimi për rritjen e buxhetit komunal nga të hyrat vetanak të vitit 2019.**
- 3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndarjen e mjeteve nga projekti në projekte të bashkëfinancimit.**
- 4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për lirim nga pagesa e shfrytëzuesve të hapësirave publike per periudhe kohore Mars, Prill, Maj.**

Si dhe kemi edhe një pike të cilën e propozoj nënkryetari për ndarjen e një parcele, për arsye se është një donator nga Katari për ndërtimin e një ambulante, për atë po donë ta fusim si pikë, që mos të humb donacioni, A ka dikush të diskutoj rreth rendit të ditës ju lutëm, kush është që të miratohet rendi I ditës. Konstatoj se me vota unanime u miratua rendi I ditës, edhe me këtë pike shtesë.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

1. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2019 në vitin 2020.

Ja kisha dhanë fjalën drejtorit, shkurtimisht ta paraqet.

z.Ibrahim Ramiqi: Pra është fjala për një propozim vendim, që zakonisht ndodh gjatë vitit fiskal, mjetet që grumbullohen në fund të vitit e që nuk shfrytëzohen të barten me vendim të kuvendit komunal, shuma është 145, 262 euro mjete të cilat janë grumbulluar në fund të vitit dhe nuk kanë mund me u shfrytëzuar në bazë të planifikimit të buxhetit të vitit 2019. Këto të hyra duhet të shpërndahen siç e kemi të cekur edhe në propozim vendim. Për mos me ju marr ma shumë kohë, për pyetje përgjigje jam në dispozicion të ju përgjigjem.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapim debatin rreth kësaj pike të rendit të ditës. Urdhëro!

z.Ali Bajrami: Shpjegimin e dha drejtori edhe elaborimin edhe prej praktikave të viteve të mëparshme, kemi bërë ridestinimin e mjeteve të pashfrytëzuara. Ka të bëjë me një vlerë që ndahet në tri kategori: shërbime dhe mallra, subvencione dhe transfere dhe për investime kapitale. Ne si grup parlamentar i LDK-së e mbështesim këtë propozim vendim.

znj.Mirlinda Sadiku: Si Lëvizje Vetëvendosje kemi shqyrtuar, po ashtu propozimi I parë dhe I dytë po thuaj që janë të njëjtë, që tregojnë destinimin, mirëpo ajo çka është për ne e pakjart, është se e kemi këtu asfaltimin e rrugës Skifteraj – Stubëll, kodi 48 478, shuma 64127 mijë euro. Me sa kuptoj, janë pagesat të cilat nuk janë kryer, d.m.th, do të kryhet këtë vit. Desha me ditë pranimin teknik: a e keni bërë drejtor? Unë po ju tregoj fotot, u shtrua rruga, është bërë pranimi teknik, unë nuk e di kush është ai komision për me dokumentuar. Unë e kam çuar vetë këtë rrugë, mundem me të treguar saktësisht se ku është kjo gjendje, prandaj është skandaloze, është e papranueshme. Rrugët që po shtrohen të bëhen në këtë gjendje me pranim teknik nga komuna edhe prapë të intervenohet dhe të paguhet ai operator ekonomik, për ne si lëvizje kjo është e papranueshme. Ne nuk jemi ata që do ta ndalojmë këtë bartje, por në piken e dytë do të kyçet edhe kryetari Njaziu, për arsye se i ka informacionet në lidhje me kontratën qysh është nënshkruar. Veç e kam një pyetje shumë të thjeshtë drejtor, si ka mundësi taksat e qytetareve me përfunduar në këtë gjendje, a keni përgjegjësi institucionale, sepse kjo rrugë është në këtë gjendje, kjo ka nevojë prapë me intervenuar në të brenda vitit, të shkojnë prapë pare tjera, ne vend se te destinohen për arsim, çoftë për kulturë ose për gjana të tjera. Ne duhet t'i harrojmë papërgjegjshmërinë e operatoreve ekonomik, e që janë miratuar me miratimin teknik nga ana e juaj. Keni përgjegjësi si institucion, sepse këto janë taksa të qytetareve, nëse keni pas nevojë për buxhet shtesë, na jemi kanë gjithë këtu dhe na keni pasur gjithë pro, mirëpo Lëvizja Vetëvendosje është kundër cilësisë jashtëzakonisht të dobët. Sa për informim, kjo rrugë është përruar me datë 11.11.2019, ndërsa sot jemi në muajin maj. Shikoni në çfarë gjendje është.

z.Bekim Azizi: Në lidhje në pikën e parë, por edhe e dyta, zakonisht flitet për shuma të njëjta, nuk e di pse ka pasur nevojë kështu me u ndarë kjo pike, na e dim që vitin që shkoj në rrugën skifteraj – Stubëll e poshtme kanë qenë të planifikuara 95 mijë euro dhe prej 95 mijë eurove moment që është kryer puna dhe në raportin financiar që e ke dërruar aty tregon që puna është kryer është pranuar teknikisht dhe është paguar 88 mijë 704 euro dmth punimet janë paguar aty qysh tash po ndan ti mjete dhe po ndan prej mjeteve se nuk kanë qenë të planifikuara se nuk kanë qenë të grumbulluara fare dhe ato mjete tip o I ndan për të njëjtën rrugë që është kryer vitin e kaluar kemi edhe rastin tjetër që po I ndan për zgjerimin e urës te ura Kurteshi edhe në Bincë 9930 euro. E tash na prej mjeteve që janë grumbulluar tepër nga të hyrat vetanake ti po ndan mjete për punët që janë pranuar teknikisht. Për mua kjo nuk e ka miratimin për pjesën tjetër të hyrave normale që janë mbledhur jemi në rregull. Kemi shembull riparimi I shkollave te shkollat e mesme e keni ndarë një shumë aty I dërgojmë. Unë mendoj se këto mjete që janë 97 mijë euro. Kisha propozuar me I drejtuar te riparimi I shkollës, ja ku I keni 13 punëtori, është mjerim me hy brenda atje. Unë edhe një herë po themë, e kisha propozuar, se këto mjete prej 97 mijë eurove të shkojnë për riparim të shkollës së mesme, pjesës së punëtorisë.

z.Vehbi Rama: Ne si grup I AAK-së jemi gjithmonë me përkrah, me votuar ajo çka është e mirë në interes të qytetareve, mirëpo fatkeqësisht e kemi një të kalueme disa raste të hidhura që janë shtruar rrugët edhe nga dy here por fatmirësisht një kompani është denuar një here te rruga Rexhep Bislimi që është shtruar 2-3 herë është mire që

edhe në këtë rast pse mos me dënuar firmën që e ka bërë keq e jo me paguar edhe njëherë. Unë kisha ardhur në përfundim, është mirë me punuar, ma mirë pak e mire se sa shumë e keq. Është mire me pas cilësi, jo vetëm sasi.

z.Njazi Isaku: Unë dua me u ndërlidh pak te pika e parë, se na pajtohemi te zërat e tjerë, te mallrat dhe shërbime dhe transfere, ndërsa te buxheti, ne nuk pajtohemi te asfaltimi I rrugës Skifteraj, vlera që është 64 mijë euro dhe te pika e gjashtë, ndërtimi i rrugës në Binçë dhe te “Ura e Kurteshit”, në vlerë prej 9930 euro. Tash në pjesët tjera na pajtohemi, se di pse është duke u bërë kjo pagesë, kur unë e kam shikuar kontratën, rruga Skifteraj – Stubell, ka vlerën 139 mijë euro dhe e kemi pare në çfarë gjendje është cilësia e rrugës, shumica e mediave e kanë bërë publike në çfarë cilësie u shtrua ajo rrugë, ku rruga i ka mbi 3 km dhe gjerësia 4 metra, në atë rrugë për 3 km, rrugë janë paraparë 139 mijë euro. Ky është nënshkrimi I kontratës, ndërsa nëse nuk janë paguar, atëherë me atë cilësi në pikën e dytë ne nuk mund ta votojmë këtë propozim, ndërsa te pika e parë te kategoritë të tjera, nëse vjen në kundërshtim që duhet me votuar komplet, ne nuk do ta votojmë. Nëse i tërhiqni këto që I cekem, ne do ta votojmë propozimin e pare, përndryshe nuk do ta votojmë as pikën e parë as të dytën.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: E di që nuk janë punë shtesë, nuk do të lidhem me këtë, por po lidhem me dëmtimin e rrugës. Ne kemi dal në teren dhe e kemi shikuar rruën ingjinjeri jonë fotet që I ka sjellë janë kanë edhe ma keq megjithatë është e pranuar teknikisht jam për rritje të cilësisë nuk janë për me meremetu atë asphalt ato mjete ai ka një marveshje dhe do të ju përgjigjet dhe do ta rregullon po ashtu edhe te ura Kurteshit është vendim që te rregullohen.

z.Ibrahim Rama: Disa shqetësime në lidhje me propozim vendimin. Kjo është rregull dhe ekonomistet e dinë. Qeveria komunale dhe asnjë qeveri nuk guxon me I shpenzuar mjetet që mbesin në fund të vitit për vitin tjetër me I shti ne buxhet pa pëlqimin e kuvendit komunal. Kjo nuk është as mshefësi, as risi, këtë e obligon ligji dhe këto mjete janë të sigurta janë të hyra vetanake dhe këto duhet me u shfrytëzuar në proporcion me obligimet e Komunës së Vitisë, kurse për me sqaru në fillim dy propozim vendimet dhe është koincidencë që lidhen njëra me tjetrën, po në bazë të Ligjit për Menaxhimit e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, se na kemi grumbulluar mjete ma shumë se sa e kemi pas të planifikuar dhe për këtë arsye Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike thotë: se shtimi I buxhetit duhet të shkoj me vendim te veçantë. U ngrit shqetësim te asfaltimi I rrugës Skifteraj – Stubell dhe te ura, këto nuk janë pagur, janë obligime dhe janë të raportuara me datë 31.12.2019 edhe në Ministri të Financave, asfaltimi I rrugës Skifteraj – Stubell është asfaltuar vitin e kaluar dhe është bërë pranimi teknik dhe nuk është paguar në tërësi. Na kemi dhënë urdhëresë, se të gjitha këto defekto do të rregullohen, se nuk do të ketë pagesë, ndërsa sa I përket urave aty nuk është bërë pranimi teknik ende. Edhe një here po themë, se propozim vendimi I dytë është I njëjtë me të parin, por siç ju thash më herët, për hirë të ligjit që duhet me specifiku shtimin e buxhetit me një vendim të veçantë, për atë I kemi bërë dy vendime.

z.Bekim Azizi: Na ekonomista nuk jemi, rregullat e ekonomisë nuk I dimë, por e dimë se pa e ngritë dorën na nuk mund të miratohet dhe një e dimë, se kjo nuk është nënshkruar gjatë kësaj kohe, por është nënshkruar para një viti. Ti e ke pas edhe miratimin e buxhetit për vitin 2020, që ke mund me shti këtë shumën tepër që se ke shti edhe ti besoj se nuk e ke ditë që kanë me u mbledhur pare ma shumë në vitin 2019, e nëse nuk I kishe mbledhur ku I kishe marr këto pare me I kry këto pagesa. Këto lojëra unë mendoj se janë të kaluara. Unë kisha thanë edhe njëherë, i ke këto kode të tjera që i përputhen, ne do ta votojmë a kështu komplet, ne nuk mundemi me votuar. Nënkryetar, e kam një pyetje për ty: cilat janë masat që I keni marrë për pranimin teknik që po e bani? Se këtu është ajo pjesa kryesore që po e bani dhe po ndodhin këto telashe, se këta me pas mbikëqyrë mirë punën kjo nuk ish prishë.

znj. Mirlinda Sadiku: Lëvizja Vetëvendosje ka thanë gjithë keqmenaxhim edhe keqimplementim. Pse po e themë këtë, se e planifikuar ka qenë 90 mijë euro, mirëpo e konfirmuat që është rritur për 50 mijë euro ma shumë. Qysh ka mundësi me ndodh kjo kur e keni Zyrën e Projekteve, i keni gjithë ata ingjiniera dalin në teren, hajde s’ mund për 10 mijë apo 20 mijë euro, por me lujtë projekti për 50 mijë euro, për mua kjo është shqetësuese. Atëherë çka është në pyetje këtu, nuk është hera e parë që ndodh drejtor, janë gjithë ata mekanizma, komuna kontraktin edhe kompani për hartim të projekteve, prej buxhetit komunal ndahet kogja një shumë e madhe e mjeteve, plus kemi edhe mbikëqyrje të projekteve edhe në fund çka kemi, kemi rrugë të harrnuara të Tërpezës, rrugë të harrnuara të Lubishtës, tash po ndodh edhe kjo, prandaj është shqetësuese pse nuk po ka përgjegjësi institucionale kur I keni në dorë gjithë ata mekanizma.

z.Basri Sylejmani: Unë isha lidh vetëm te rruga Skifteraj – Stubëll. Unë e kisha bërë përgjegjës vetëm nënshkruesin e kontratës, i cili ka pas si përcjellës të rrugës pa shkuar një në shtëpi, prej këtyre nuk ka asgjë të mirë.

z.Jakup Demiri: Desha me pyet drejtorin, se në pasqyrat financiare vitin e kaluar e kemi pasur një kompani për me i marr mostrat e asfaltit që I shtron po më intereson a ka marr naj mostër dhe a kemi naj rezultat të kësaj rruge dhe shumë të tjerave, ndërsa te rrugët cilësia e asfalteve kjo është e fundit, por gjene një të mire që është shtruar.

z.Ali Bajrami: Shpjegimet që i dha drejtori, shqetësimet që u ngritën, ato janë evidente, ato që janë parë për mua ishte shqetësuese, por ai mu hek se nuk ka duplikim të pagesave që për mua është shumë me rëndësi se një projekt po paguhet 2 herë ato nuk qëndrojnë.

z.Nuredin Lutfiu: Edhe unë desha me u ndërlidh me rrugën Skifteraj – Stubëll. Kërkoj nënkryetar, që në mbledhjen tjetër me ardh emrat e komisionit, të cilët e kanë pranuar dhe të merren masa për ata të cilët e bëjnë pranimin teknik dhe rruga dëmtohet shumë shpejt.

z.Ibrahim Rama: Kuvendi ka drejtë me ngrit shqetësim, të kërkoj raporte, të bëjë thirrje publike për denoncim të së keqes dhe unë ju përkrahi në plotni. Po ky vendim në asnjë formë nuk e përkeqëson gjendjen e situatës në projektet e Komunës së Vitisë, po edhe si vendim është ligjor nga ana e juaj. Nuk ka mundësi të ndahet një pjesë e të hyrave vetanake për vitin 2020, e një pjesë jo. Na e dimë, se deri në 5 përqind kemi drejt vete mi bart pa I sjell në kuvend hiq. A moment se e kalon 5% e kemi obligim që ti sjellim në kuvend, tash po përgjigjem në pyetjen e Bekimit, qysh ke mund me ditë që ke me pasur grumbullim të të hyrave vetanake në fund të vitit ma shumë jo nuk kam mujt me ditë, por na kemi pas shtesë në të hyrat vetanake prej 97 mijë euro dhe ato mjete na i kanë mundësuar që me i paguar obligimet e vitit të kaluar dhe që ma mirë që nuk e kemi dëmtuar buxhetin e vitit 2020, se obligimet komuna duhet me I mbuluar dyqysh. Unë ju kisha lute që ta miratoni këtë propozim vendim.

z.Njazi Isaku: Drejtori e ceku se nuk ka mundësi me e terhek na që i bëjmë këto dy kërkesa, atëherë na rrjedhimisht e votojmë kundër për arsye se tu i pas këto dy projektet që kanë pasur cilësi të dobët. Ne si asamblist nuk kemi par asnjëherë ndonjë ndëshkim nga komuna as nga komisioni, dhe ne si grup dy propozimet do të votojmë kundër tyre edhe se për pikat tjera pajtohem se kemi qenë pro.

z.Bekim Azizi: Unë nuk kërkoja veç ajo pjesë me u votuar, por unë kërkoja kjo pjesa 97 mijë euro të hynë në kodin te meremetimi I shkollave. Unë pata propozim konkret, që komplet ato mjetet të të hyrave vetanake. Unë propozova që te meremetohen punëtoritë që shkolla teknike e shfrytëzon, edhe te ajo që e ceka te rritja, ti si drejtor me siguri e ke planifikuar se dikun do t'i marrësh paret, merri aty ku I ke planifikuar por qeto rritje çka janë, t'i qesim te shkolla. Ky është propozimi konkret.

z.Ibrahim Rama: Na s'kemi drejtë me I qit në asnjë pagesë tjetër, se për me I bart këto mjete unë duhena me pas të kodifikuar këtë projekt, d.m.th të regjistruar që është projekt në vazhdim apo në fillim ose ka fundi kishmi pasur mundësi me I bart, përndryshe ne si ide e kemi për vitin 2020, por nuk e kemi të planifikuar me buxhet tonin.

Kryesuesi z.Naim Pira: Atëherë unë po e qes në votim këtë propozim. Kush është që të miratohet ky propozim vendim. Me 13 vota pro kalon ky propozim vendim.

Si pikë të dytë kemi:

2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimi për rritjen e buxhetit komunal nga të hyrat vetanake të vitit 2019

Ja kaloj fjalën drejtorit te Financave, ta paraqes këtë pikë.

z.Ibrahim Rama: Mos me ju marr shumë kohë, është e njëjta problematik që është sqaruar në piken e parë, për pyetje apo ndonjë sqarim jam në dispozicion të ju përgjigjem.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: A donë ta merr fjalën dikush ju lutem. Pasi që nuk ka, e qes në votim këtë pikë të rendit të ditës. Ju kisha lut që me ngritje dore kush është pro kalon edhe kjo pikë e rendit të ditës me shumicë votash.

Si pikë të trettë të rendit të ditës kemi:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndarjen e mjeteve nga projekti në projekte të bashkëfinancimit

Urdhero drejtor!

z. Bekim Azizi: Me këtë propozim, të nderuar këshilltar komunal, shifet se me propozimin e kryetarit të komunës dhe me miratimin e juaj do të sigurohen mjetet për ekzekutimin apo ma mirë me than pagesën e obligimeve që kanë të bëjnë me dy projekte që janë zhvilluar në Komunën e Vitisë, që kanë filluar në vitin 2019. Është fjala për asfaltimin e rrugës Sadovinë e Jerlive – Verban dhe renovimin e Komunës së Vitisë. Është fjala për tri objektet te tatimi në pronë. Komuna ekzistuese dhe salla për mbledhjet e kuvendit komunal. Kjo ishte në pika të shkurtra. Për pyetje apo ndonjë sqarim, jam në dispozicion të ju përgjigjem.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: A donë ta merr fjalën dikush ju lutem?

z.Bekim Azizi: Prapë është një diçka që po na përsëritet. Rruga Sadovinë e Jerlive – Verban është e përfunduar. Këto praktika nuk kanë qenë drejtor, a ti ka pështjellë pandemia a nuk e di çka është puna. Asfaltimi është I përfunduar, na jena tu nda mjete. Tash me plotësuar një kontratë të nënshkruar ose te renovimi I objekteve të komunës. Që 1 vit ka filluar meremetimi, na tash pasi po kryhen punët po ndami mjete për ta. Kjo praktikë pasi të kryhen punë me nda mjete se kemi pas edhe s’është e mirë hiq drejtor, është participim me donator. Unë e votoj se është projekt që është përfutur prej ministrie, mirëpo megjithatë kjo nuk është praktikë e mirë. Pasi të kryhet projekti mi nda mjetet.

z.Ibrahim Rama: Unë tu e mbrojt qeverinë komunale, ju mbroj juve dhe gjithë qytetareve të komunës në atë kuptimin ligjor. Kjo është e obliguar me ligj. Marrëveshjet e kryetarit të komunës janë ligjore, duhet me u bashkëfinancuar nga buxheti komunës, do me thane asnjë shkelje ligjore nuk ka. Kur bëhet një participim për një projekt që kryetari I komunës në çdo kohë I ka duart të lira me gjetë donator, me gjetë bashkëfinancues për projektet. Përndryshe me buxhet tonin këto dy projekte nuk kena mujt me I pas sivjet të përfunduara.

z.Ali Bajrami: Nuk do të hy atë çka e thane parafolsit e mi në kontakt me qytetaret e Verbanit. Përmes rrjeteve sociale më kanë obliguar me falënderu të gjithë akteret për përfundimin e rrugës Sadovinë e Jerlive – Vorban, që është bërë një rrugë me standarde ma të larta dhe me cilësi shumë të mirë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi nuk ka tjerë për diskutim, e qes në votim këtë pikë të rendit të ditës. Kush është pro. Konstatoj se me shumicë votash miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të katërt të rendi të ditës kemi:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për lirimin nga pagesa e shfrytëzuesve të hapësirave publike për periudhe kohore Mars, Prill, Maj.

Ja kisha dhanë fjalën nënkryetarit.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Propozim vendimin e keni para jush, besoj se është i shkurtër dhe i kjart. Nuk dua me zgjatë ma shumë. Për ndonjë konsultim jam për të ju ndihmuar.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: A donë ta merr fjalën dikush ju lutem.

znj.Mirlinda Sadiku: Lëvizja Vetëvendosje atë ditë në takim me kryetarin ka dal me këtë propozim. Mirëpo edhe se e keni propozuar për muajin mars, prill edhe maj na jemi të vetëdijshëm se Komuna e Vitisë është komuna e parë e cila ka hy në karantinë edhe po thuaj që nder të fundit që doli nga karantina edhe impakti te bizneset private ka me qenë i madh, tu ja shtuar edhe atë se gjithmonë flas sipas ekspertëve të fushës. z.Lul Raka paralajmëroi, që edhe në vjeshtë do të kemi një pandemi. prapë uroj që mos të kemi, por megjithatë a do të kishte hapësirë që të paktën të jetë për gjashtë muaj ose për tërë vitin, për arsye se shumë nga komunat e kanë bërë për me u liruar nga pagesat, sepse edhe ashtu bizneset janë buzë kolapsit, tu e ditë që nuk kanë operuar për një kohë të gjatë. Prandaj mirë do të ishte drejtor, paraprakisht të na i sjellë edhe një analizë, se cili do të ishte impakti në buxhetin fiskal dhe po ashtu ne do të ishim shumë ma të lirë që me dhënë një opinion të caktuar, ani se e keni propozuar për këta tre muaj. A ka mundësi të bëhet për 6 muaj ose për një vit, ashtu si ka vepruar Komuna e Lipjanit , Gjilanit, Gjakovës

etj. Tash kur jemi në dyshim, që mërgata a do të na vij apo nuk do të na vij, është mirë me marr parasysh këtë propozim tonin.

z.Bekim Azizi: Unë vetëm pak kisha për të plotësuar, se këtu janë paraqitur vetëm tri pika: shfrytëzimi I hapësirave publike para kafiterive, shfrytëzimi I hapësirave publike për vendosjen e reklamave dhe parkingjet publike. Këto tri pika janë paraqitur që do të lirohen për tre muaj. Unë mendoj se është e mjaftueshme për tre muaj, sepse kjo nëse zgjat apo ka probleme, na mund ta vazhdojmë, mirëpo nuk e di këtu sa kemi objekte me qera të dhëna, që janë bizneset atje tu funksionuar dhe cilat biznese nuk kanë punuar, se na e dim që një pjesë kanë punuar këtu në propozim vendim, të shënon objektet që janë dhënë me qera. Unë mendoj se duhet me hy edhe ato lokale.

z.Ali Bajrami: Unë jam i mendimit, që ky propozim vendim të votohet në formën si na ka ardhur për tre muaj. Dashtë Zoti që ta përfundojmë këtë pandemi, t'i kthehemi normalitetit, por na jemi ata prapë, nëse kemi vështirësi, bizneset që operojnë në Komunën e Vitisë ta marrim një vendim tjetër dhe të marrim masa shtesë për lehtësimin e tyre. Mirlinda, vetëm një njoftim po ta jap. Ministri i financave në detyrë, në udhëzimin e ri tekstativisht e ka cek, bizneset që operojnë, tregtia me pakicë furrat e bukës edhe farmacitë nuk lirohen prej pagese së taksës se janë duke krijuar të hyra kjo është shumë me rëndësi, na jemi duke e bërë për bizneset që nuk janë duke krijuar të hyra.

z.Njazi Isaku: Ne pajtohemi me këtë propozim vendim, por unë kisha thane që këtij me ja shtuar edhe çerdhen publike. I kam parë tjerat komuna, që prindërit deri sa të hapën çerdhet të lirohen prej pagese në çerdhet publike. Po ashtu që ja vlen, dhe mendoj që duhet me ba edhe në subvencione, që herën e parë ne nuk kemi paraparë subvencione në sport. I kemi dy klube po ashtu edhe në kulturë me nda ndonjë subvencion. Unë mendoj që edhe aty kemi shoqëri kulturore, ndërsa për ndërmarrjet lokale, na skemi 100% që është e komunës. E kemi "Ekohixhienen" 49%, që është e komunës, edhe aty nuk e di në çfarë gjendje është, qysh janë duke operuar me financa, a rrezikohen si ndërmarrje. Në këtë aspekt mendoj se edhe këtu është dashtë me marr informata, edhe pse jo me ju ndihmuar atyre.

z.Vehbi Rama: Ky propozim vendim është për lirim nga pagesa për kafiteritë, për reklamat edhe për parkingje. E ceki kolegu Ali, është e vërtetë që prej qeverie është ardhur vendim, që shitoret ushqimore, farmacitë edhe furrat mos të lirohen. Ajo është fakt, se ato edhe kanë punuar, po shumicën e rasteve ato që I ceke nuk kanë hapësira publike para lokaleve, por dihet se hapësirat publike që I kanë e që I shfrytëzojnë janë kafiteritë dhe ato nuk kanë punuar as në mars as në prill dhe tash jemi në mesin e majit dhe ato nuk janë duke punuar.

Kryesuesi z.Naim Pira: Unë e qesë në votim. Kush është që të miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës ju lutëm. Konstatoj se me vota unanime u miratua edhe kjo pikë e rendit të ditës, dhe

Si pikë të fundit të rendit të ditës, kemi:

5. Propozim për ndarjen e një parcele, për arsye se është një donator nga Katari, për ndërtimin e ambulants në Tërpezë

Për ma shumë, ja kaloj fjalën nënkryetarit.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Unë para se me hy te kjo pikë, pajtohena, që edhe objektet që janë të dhëna me qera ato që nuk janë ndesh me udhëzimet administrative. Para jush sot ju ka shpërnda një propozim vendim, të cilët kërkohet një lokacion. Janë në bisedë drejtoresha e QKMF-së, së bashku me drejtorin e Shëndetësisë, me Kuvajtin, të cilët ata kanë kërkuar që ta kenë vendimin mbi ndarjen e parcelës, dhe do të ishte mirë që ne ta kalojmë sot këtë pikë. Ndoshta do të jemi edhe përfitues, kemi shpresa të mëdha. Unë mendoj se do të ishte edhe në dobi të qytetareve të Vitisë, por do të ishte edhe lehtësim, se ne kemi të parapame edhe me buxhet të komunës.

Kryesuesi z.Naim Pira: A ka dikush rreth kësaj pike. Nëse nuk ka, po e hedhi në votim për miratim këtë pikë të rendit të ditës. Konstatoj se me vota unanime u miratua kjo pikë.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12:50 min.

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Naim Pira
